

Ikona “Ungjëllizimi” (Periudha post-bizantine)



Ikona paraqet një prej skenave kryesore në artin bizantin, skenën e Ungjëllizimit . Skena është vendosur në një ambjent të jashtëm ku Kryeëngjëlli Gabriel jep lajmimin tek Shën Mëria në lidhje me shtatzaninë e saj të shenjtë.

Kryeëngjëlli është duke shkelur mbi re të shumta puplore me hiton blu si dhe me emapor të kuq, të cilat qartësojnë natyrën e tij hyjnore. Përballë tij qëndron figura e Shën Mërisë që shpreh tapinosje duke mbajtur librin e shenjtë në një dorë kurse tjetrën ia drejton Kryeëngjëllit në mënyrë aprovimi kundrejt lajmimit. Mes tyre shohim një poce të lulëzuar me zambakun rozë.

Poshtë saj jepet viti i pikturimit 1865.

